

Analiza e procedurave të inicuarra për kundërvajtje, ndaj radiodifuzerëve gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016

Shkup, 21.08.2017. – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele përpiloi një Analizë të procedurave të inicuarra për kundërvajtje, ndaj radiodifuzerëve gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016, për shkeljet e kryera të dispozitave të Kodit zgjedhor. Qëllimi i Analizës është shqyrtimi i rezultateve nga procedurat e inicuarra për kundërvajtje, identifikimi i faktorëve që kanë ndikuar në miratimin e vendimeve gjyqësore për këto procedura, si dhe për dhënie të rekomandimeve me qëllim të përmirësimit të rregullativës ligjore.

Në Analizë janë përfshirë procedurat e kundërvajtjes, që janë inicuar gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016. (që nuk u realizuan) si dhe procedurat kundërvajtëse që janë iniciuar gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016, e që u mbajtën më datë 11 dhjetor 2016.

Analiza e procedurave të kundërvajtjes ndaj radiodifuzerëve gjatë Zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2016, mund të merret në këtë

[link](#)